2559/28
20.11.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË INDUSTRISË DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E ENERGJISË DHE EFIÇENCËN E ENERGJISË

Nr. 8676/1 Prot. Tiranë, më 18/11/2026

Lënda: Kthim përgjigje mbi projektmetodologjinë e përcaktimit të vlerave referuese të konsumit të energjisë elektrike.

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)
Rruga "Irfan Tomini", Njësia Administrative Nr.7, Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 2559/11 Prot., datë 21.10.2026 "Ftesë për konsultim dhe paraqitje komentesh mbi *"Metodologjia e përcaktimit të vlerave referuese në rastet kur të dhënat e matjes së energjisë elektrike janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme"*, protokolluar në MIE me Nr. 8676 Prot., datë 26.10.2026, për të cilin ERE ka filluar procedurën me Vendim të Bordit të ERE-s Nr. 287, datë 08.10.2026, ju bëjmë me dije si vijon:

Në nenin 2, pika 3 "Kohëzgjatja e faturimit me vlerë referuese" sugjerojmë të përcaktohet shprehimisht kufiri maksimal kohor prej 3 (tre) muaj, në përputhje me përcaktimet e nenit 92 pika 5 të ligjit Nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike".

Në nenin 3 pika 1 "Fillimi i aplikimit të vlerës referuese" sugjerojmë të rishikohet me qëllim reflektimin e saktë të kompetencave dhe përgjegjësive të Operatorit të Rrjetit dhe Furnizuesit, sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 59/2026. Në këtë drejtim, projektmetodologjia duhet të përcaktojë një ndarje të qartë ndërmjet përgjegjësisë së Operatorit të Rrjetit për përcaktimin dhe llogaritjen e vlerës referuese, si dhe përgjegjësisë së Furnizuesit për faturimin e klientit mbi bazën e kësaj vlere, e cila më pas duhet të pasqyrohet edhe në dispozitat e tjera të projektmetodologjisë, veçanërisht në ato që rregullojnë faturimin, korrigjimin e tij dhe raportimin.

Në nenin 4, pika 3, përcaktohet se metoda e konsumit të të njëjtit muaj të vitit të mëparshëm ka përparësi ndaj metodave të tjera të përcaktimit të vlerës referuese. Ky përcaktim rezulton i përsëritur në raport me nenin 9, i cili rregullon në mënyrë të përgjithshme rendin e aplikimit të metodave. Në këto kushte, duke qenë se pika 3 e nenit 4 nuk shton një element të ri normativ përtej përcaktimeve të pikës 1 të të njëjtit nen dhe nenit 9, sugjerojmë rishikimin e kësaj dispozite, me qëllim shmangien e përsëritjeve dhe përcaktimin e hierarkisë së metodave të përcaktimit të vlerës referuese.

Në nenin 12 të projektmetodologjisë parashikohen mekanizmat e kontrollit dhe verifikimit, por nuk parashikon shprehimisht një mekanizëm përmes të cilit klienti mund të kundërshtojë vlerën referuese, kur disponon të dhëna ose dokumentacion që dëshmon se ajo nuk pasqyron konsumin e pritshëm apo nuk pasqyron kushtet aktuale të përdorimit të objektit. Ndaj sugjerojmë që të shqyrtohet mundësia e parashikimit të procedurave përkatëse të verifikimit dhe rishikimit të vlerës referuese, me qëllim dhënien e një vlere referuese sa më përfaqësuese.

Së fundmi, në nenin 13 "Parimi i faturimit mbi bazën e konsumit faktik", sugjerojmë të shqyrtohet mundësia e heqjes së këtij neni, duke qenë se përmbajtja e tij është reflektuar në dispozitat e tjera të projektmetodologjisë dhe nuk shton elemente të reja rregullatore.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Besjan Kadiu